



FTESË PËR OFERTË

1. Ju jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për shërbimin e furnizimit të Shoqatës “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare”, Durrës *me materiale kancelarie (Ngjitës, Boje Akrilik, Tuba boje, Letër, Kartona)* për produktet e listuara në aneksin A, bashkangjitur ftesës për ofertë, në kuadër të projektit “**Creative culture-based Durrës heritage development**” financuar nga UNOPS.
2. Ju mund të jepni ofertën Tuaj për furnizimin me materiale kancelarie për të cilat do të ketë procedurë vlerësimi dhe do të lidhet kontratë me ofruesin/it më të mirë. (Ju mund të paraqisni ofertën tuaj duke u bazuar në ftesës për ofertë, pasi të keni lexuar me kujdes pikat e saj, pasi ato do të jenë pjesë e vlerësimit tuaj).
3. Vlerësimi Juaj duhet të dërgohet në adresën:
info@udhetimiilire.org dhe/ose udhetimilire@gmail.com
4. Afati i fundit i pranimit të ofertave është: **08.09.2022 ora 17⁰⁰**
5. **Detajet:**
 - Oferta Juaj duhet të paraqitet sipas kërkesave të poshtë shënuara.
 - Ky tender zhvillohet për shërbimin e furnizimit të Shoqatës “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare”, Durrës me materiale kancelarie (Ngjitës, Akrilik, Tuba boje, Letër, Kartona)
 - “UiL- LdV”, Durrës do të furnizohet nga “Shitësi” sipas kërkesës të “UiL- LdV”, Durrës.
 - Oferta Juaj duhet të paraqitet *sipas njësisve të përmendura në Aneksin A.* (Ju lutemi lexoni me kujdes njësitë e tyre).
 - Preferohen subjekte të licensuar me objekt veprimtarie në përputhje me shërbimet e kësaj kërkesë për ofertë.
 - Preferohen subjekte që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në Durrës.
6. **Çmimi**
 - Oferta Juaj duhet *të paraqitet në LEK, duke përfshirë TVSH dhe çdo taksë, transportin apo shpenzim tjetër.*
 - Oferta Juaj duhet të paraqitet për çdo material dhe në total.
 - Çmimet do të jenë të pandryshuar gjatë kohëzgjatjes së kontratës.
7. Oferta Juaj duhet të shoqërohet nga **dokumentet** e mëposhtme:
 - Fotokopje e ekstraktit të Regjistrimit Tregtar e lëshuar nga QKR,
 - Fotokopje e çertifikatës së regjistrimit si person i tatueshëm nga organet përkatëse.
 - Numrin e llogarisë bankare në një bankë të nivelit të dytë.



8. Për të konstatuar cilësinë si dhe llojin e produkteve që dëshirojmë (në mënyrë që oferta juaj të jetë sa më reale, edhe pse specifikimet janë dhënë të sakta në Aneksin A), mund të kontaktoni nga data **25.08.2022** deri më datë **08.09.2022**, ora **09⁰⁰ - 17⁰⁰** në:

info@udhetimilire.org dhe/ose udhetimilire@gmail.com

9. Të dhënat e kontratës:

Afati: 6 muaj

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është shitja nga “Shitësi” tek Shoqata “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare” i produkteve të specifikuar në aneksin A të kësaj Kontrate.

“Shitësi” nuk mund të bëjë asnjë ndryshim në sasi dhe llojin e kërkuar të produkteve, edhe nëse kjo kërkesë vjen nga marrësit në dorëzim. Çdo ndryshim do të bëhet vetëm me shkrim dhe e firmosur nga palët e kësaj kontrate.

“Shitësi” është i detyruar të dorëzojë produktet sipas cilësisë që ai ka konstatuar në paraqitjen nga ana jonë, të materialeve që ne dëshirojmë sipas komunikime që UiL do të ketë me shitesin.

Çmimet dhe pagesa

“Shitësi” për periudhën e kohëzgjatjes së kësaj kontrate (6 muaj), nuk mund të bëjë asnjë ndryshim në çmimet e ofruara. Nëse “Shitësi” ndryshon çmimet e përcaktuara në këtë kontratë, Shoqata “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare” do të zgjidhë në mënyrë automatike këtë kontratë dhe do të vazhdojë blerjen nga një nga firmat e tjera të konsideruar fituese në tender.

Pagesa, do të paguhet Brenda njëzet (20) ditëve kalendarike nga dita e marrjes së shërbimit/ të mirave dhe pranimi të faturës nëpërmjet transfertës bankare.

Garancia

“Shitësi” i garanton Shoqatës “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare” se produkti është sipas sasisë dhe specifikave teknike të përshkruar në Aneksin A dhe përputhen në çdo aspekt me kërkesat dhe rregullat e kërkuara dhe parashikuara. “Shitësi” i garanton Shoqatës “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare” se produkti do të jetë pa defekte.

“Shitësi” i garanton Shoqatës “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare” se produkti do të jetë sipas cilësisë së konstatuar në paraqitjen nga ana jonë të produkteve që ne dëshirojmë e që UiL do të konfirmojë me Shitesin.

Nëse Shoqata “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare” gjatë afatit të kohëzgjatjes së kësaj kontrate do të konstatojë shkelje të pikave të nenit 5, Shoqata “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare” do të zgjidhë në mënyrë automatike këtë kontratë dhe do të marrë masa që nga rimbursimi i kostos dhe shpenzimeve, deri në përjashtimin e firmës nga pjesëmarrja në tenderat e ardhshëm.



Kushtet e konfidencialitetit

Palët janë të detyruara të ruajnë plotësisht konfidencialitetin dhe të mos u bëjnë të njohur të tretëve asnjë informacion që ato mund të marrin, si gjatë zbatimit të kësaj kontrate ashtu edhe pas përfundimit të saj.

10. Për informacione të mëtejshme ju mund të kontaktoni në:

info@udhetimilire.org dhe/ose udhetimilire@gmail.com

11. Ju lutem konfirmoni në e-mailin e sipër shënuar marrjen e kësaj ftese dhe nëse ju pranoni të merrni pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Sinqerisht,

Shoqata “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare”



FORMULARI I OFERTËS

Datë. ___/___/___

Emri i Ofruesit _____

Për:

Emri i Përfituesit: **Shoqata “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare”**

- Numri i biznesit apo numri personal identifikues: **L52404702R**

- Adresa: Lagja 3, Rruga Egnatia; Durrës

- Tel/E-mail: info@udhetimilire.org , udhetimilire@gmail.com

Procedura e prokurimit: **Prokurim i Hapur**

Përshkrim i shkurtër i shërbimit/mallit: **Ofrimi për shërbimin e furnizimit me materiale kancelarie (Ngjitës, Akrilik, Tuba boje, Letër, kartona)**

Ky kuotim/propozim dhe pranim i juaj themelon një marrëveshje mes nesh.

Nënshkrimi i autorizuar: _____

Emri dhe titulli i nënshkruesit: _____

Emri i ofertuesit/kompanisë: _____

Adresa: _____



Aneks A

Kushtet e përgjithshme të Mallrave/shërbimeve

Nr	Përshkrimi	Specifikime teknike	Çmimi/njësi	Sasia	Çmimi/ total	Kriteret e vlerësimit
						1. Çmimi për njësi 70 pikë 2. Emri (reputacioni) në treg i Ofruesit. 10 pikë 3. Kushtet e pagesës (afati, % e zbritshme, etj.) 5 pikë 4. Eksperiencat e mëparshme me biznesin 15 pikë
1	Ngjitës	Kuti		30		
2	Boje Akrilik	Pako		20		
3	Tuba Boje	Copë		50		
4	Letër, Kartona	Me logo / kg		25		
5	Spango	Copë		50		



A është vlera e TVSH e përfshirë në çmimin e mësipërm? PO/JO	
Afati kohor për të cilin janë të vlefshme këto çmime	
Minimumi i ditëvepërdorëzimit e mallit (ditë)	
Mënyra e pagesës (cheque ose transfertë) (E preferueshme në Intesa Sanpolo Bank, ku Shoqata “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare”, Durrës operon) Ju lutemi të specifikoni në cilën bankë dhe numrin e llogarisë)	
Nësejeni person juridik a siguronifaturë me T.V.SH? PO/JO	
Nesëjeni person fizik a siguronifaturë MODUL 4? PO/JO	
Data e dorëzimit të ofertës	
Vula e kompanisë	